



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 10 Shtator 2021

Nr: 443

V E N D I M

PËR

**DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË,  
KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË KOALICIONIT PD-AN, QARKU  
LEZHË, ZJ. ELDA ARTAN HOTI**

Në mbështetje të neneve 19 pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, 163 pika 7 dhe 164 pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ

Me shkresën nr. 1880/1 prot., datë 10.09.2021, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, vakancë kjo e krijuar për shkak të dorëheqjes, të z. Mark Pjetër Marku, i zgjedhur deputet në zonën zgjedhore, qarku Lezhë, propozuar nga të koalicionit “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim”.

Koalicioni “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim”, është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 107, datë 02.03.2021.

Komisioni Rregullator me vendimin nr. 21, datë 13.07.2021, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të zhvilluara në datë 25.04.2021.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 414, datë 23.06.2021 miratoi shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, përcaktimin e kandidatëve fitues si dhe rirenditjen e kandidatëve të cilët nuk kanë përfutur mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese, në zonën zgjedhore qarku Lezhë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.04.2021.



Sipas këtij vendimi, koalicioni “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim” për zonën zgjedhore qarku Lezhë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.04. 2021, ka fituar 04 (katër) mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumemërore e koalicionit “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim”, qarku Lezhë, janë:

numri rendor 01 (një) z. Mark Pjetër Marku, numri rendor 02 (dy) z. Agron Nikolle Gjekmarkaj, numri rendor 03 (tre) zj. Lindita Ilir Metaliaj, numri rendor 04 (katër) z. Kastriot Pren Piroli,

Rezulton se lista shumemërore e koalicionit “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim”, në zonën zgjedhore, qarku Lezhë, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë.

Në këto kushte zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 163 pika 7 dhe nenit 164 pika 2, të Kodit Zgjedhor si dhe vendimit nr. 414, datë 23.06.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në të cilin është miratuar rirenditja e kandidatëve të cilët nuk kanë përfutur mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese.

Sipas këtij vendimi, rezulton se, kandidatit të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati me rendor 05, (pesë) zj. Elda Artan Hoti.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant.

Për sa më sipër, kandidati për deputet, zj. Elda Artan Hoti, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 2513 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i deputetit. Pas verifikimeve të kryera, referuar pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatoj se të dhënat e kandidatit për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Lezhë, për Kuvendin e Shqipërisë, zj. Elda Artan Hoti, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e deputetit në Kuvendin e Shqipërisë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i deputetit z. Mark Pjetër Marku, i përket kandidatit vijues në listën shumemërore të koalicioni “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim”, në zonën zgjedhore, qarku Lezhë, i renditur me numër rendor 5, (pesë) zj. Elda Artan Hoti.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, 163 pika 7 dhe 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe në Kreun V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”



## V E N D O S:

1. Dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të koalicioni “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim”, në zonën zgjedhore qarku Lezhë, zj. Elda Artan Hoti.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Illirjan CELIBASHI**

